



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

**Konuma e Rahovecit**  
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Komuna Rahovec shpall:

## Konkurs

### Pranim

[Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.](#)

<b>Emri i grupit</b>	Specialistë i Sigurisë Ushqimore
<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Zyrtar për Blegtori, Bletari dhe Veterinari
<b>Klasa e pozitës</b>	Profesional 2
<b>Koeficienti/Paga</b>	4.95
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	19/12/2023
<b>Afati për aplikim</b>	20/12/2023 - 18/01/2024
<b>Institucioni</b>	Komuna Rahovec
<b>Departamenti</b>	Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural
<b>Divizioni</b>	
<b>Vendi i punës</b>	Zyrtar për Blegtori, Bletari dhe Veterinari
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00013011
<b>Kodi</b>	RPC0006550



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

Të zhvillojë, organizojë dhe të mbikqyrë zbatimin e programeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore brenda territorit të Komunës së Rahovecit.

Verifikon zbatimin korrekt të sistemit të ambientit, sigurisë dhe cilësisë.

Siguron zbatimin e procedurave emergjente në fuqi në Komunën e Rahovecit.

Kontrollon dhe kujdeset për përmirësimin e procedurave të sigurisë dhe kontrollit të cilësisë nga faza e lëndëve të para deri në përfundim të produktit në Kompanitë brenda territorit të Komunës së Rahovecit.

Hulumton tregjet aktuale të konsumit dhe teknologjitë e fundit për të zhvilluar konceptet të reja të produkteve.

Shqyrton kërkesa të ndryshme të parashtruara nga palët.

Shqyrtimi i kërkesave për vlerësimin e dëmeve të pemëve, perimëve dhe produkteve tjera bujqësore nga fatkeqësitë natyrore, si dhe dalja në terrene për të verifikuar dhe për ta bërë vlerësimin e dëmeve.

Përkrahje administrative dhe profesionale në komisione të ndryshme.

Ndihmon në procesin e aplikimeve për pagesa direkte në MBPZHR

## 2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve-drejtimi Teknologji Ushqimore.
- Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK);
- **Kualifikime të posaçme formale:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



## 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

---

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

## 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

---

Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore

Kopjet e dëshmisë së punësimit (Vërtetime dhe Trusti Pensional). • Kopjet e dëshmisë së trajnimeve

Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (vlenë vetëm për zyrtarë publik)

Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende (vlenë vetëm për zyrtarë publik)

Vërtetim që nuk ju është marrë zotësia për veprim.

Dëshmi e certifikatës shëndetësore origjinale për kandidatin e suksesëshem(kandidati i cili emërohet ).

Kopja e certifikatës nën hetime.

Kopja e Leternjoftimit.

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 02/02/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net> )

## 7. Kriteret specifike shtesë

---

## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

## 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 10. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

